

## **PLANI I MASAVE PËR VAZHDIMËSINË E BIZNESIT NË KUSHTET E PANDEMISË TË SHKAKTUAR NGA COVID-19 (i rishikuar)**

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19, në zbatim të Aktit Normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe në zbatim të akteve të brendshme të shoqërisë ALBSIG JETË, Shoqëria ALBSIG JETË harton planin (e rishikuar) për vazhdimësinë e biznesit për shkak të pandemisë të shkaktuar nga COVID-19.

Plani i Vazhdimësisë së Aktivitetit ("Plani") i ALBSIG JETË sh.a. ("Shoqëria") është në përputhje me planin e vazhdimësisë së aktivitetit dhe katastrofave të vitit 2020 të shoqërisë ALBSIG JETË, i miratuar nga Këshilli Mbikqyrës. Ky plan përbëhet nga një sërë hapash që duhet të ndiqen në një situatë të pazakontë të aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë, për shkak të pandemisë të shkaktuar nga COVID-19. Plani do të ndihmojë Shoqërinë që të reagojë shpejt ndaj situatës emergjente për të garantuar vazhdimësinë e biznesit, ofrimin e shërbimit ndaj klientëve dhe minimizimin e humbjeve. Masat sigurojnë vijimin e aktivitetit të biznesit të shoqërisë dhe rikthimin në aktivitetin normal gjatë kohës së periudhës së pandemisë.

Situata pandemike ka ndikuar në infrastrukturën e shoqërisë, sistemet elektronike, të sigurisë dhe ato të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore. Për rrjedhojë, për vijimin e biznesit kërkohet marrja e masave dhe transferimi i aktivitetit në zyra të veçanta apo krijimi i hapësirave më të mëdha fizike për vijimin normal të aktivitetit të biznesit, në kushte pandemie.

Natyra e situatës emergjente dikton masat parandaluese në funksion të mbrojtjes nga COVID-19. Masat adekuate të shoqërisë kanë për qëllim për të mbrojtur punonjësit e bashkepunëtorët, si dhe klientët.

Situata e pandemisë dikton marrjen e masave parandaluese dhe mbrojtëse për stafin, ofrimin e shërbimit në distancë të pjesës së stafit që do të qëndrojnë në banesë (nëse do të jetë e nevojshme), përshtatjen e orarit të punës për punonjësit e pranishëm në ambjentet e shoqërisë dhe/ose ruajtjen e disancimit fizik në zyrat dhe Drejtorinë e ALBSIG JETË sh.a. Në çdo rast masat janë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi gjatë kësaj shtate. Masa të veçanta janë parashikuar për pjesën e shërbimit ndaj klientëve në vendet ku ofrohet shërbimi, në selinë qendrore dhe degë.

Çdo punonjës i Shoqërisë do të jetë përgjegjës që të sigurojë zbatimin e këtij plani nga vartësit e tij.

### **OBJEKTIVAT:**

- të garantojë sigurinë e punonjësve të Shoqërisë gjatë situatës së pandemisë;
- të sigurojë vijimin e aktivitetit të biznesit të shoqërisë gjatë pandemisë;
- të ulë efektin që reduktimi i numrit të punonjësve dhe orarit të punës mund të ketë tek klientët dhe palët e tjera të interesuara;
- procesi i vendimeve për të implementuar strategjinë e vijimit të aktivitetit të biznesit do të ndërmerret për t'u dhënë shërbimet klientëve në kushtet e pandemisë.

## ORGANIZIMI I EKIPIT TË MENAXHIMIT

Ekipi i menaxhimit të situatës të shkaktuar nga Covis 19 – ky ekip përbëhet nga anëtarë të menaxhimit të lartë dhe është përgjegjës për ndërmarrjen e masave për vijimin e aktivitetit të biznesit gjatë epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, duke miratuar masat adekuate për përballimin e situatës.

*Ervin Spahiu, Renato Bihuci dhe Denis Muçodema.*

Ekipi i vijimit të aktivitetit – ky ekip përbëhet nga anëtarë të personelit që konsiderohen shumë të rëndësishëm për vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë. Në këtë ekip përfshihen përveç menaxhimit të lartë, drejtuesit e departamenteve dhe njësiteve si dhe personat e caktuar që do të sigurojnë vijimin e punës të shoqërisë. Menaxhimi i lartë kujdeset për sigurimin e zëvendësimit të personave me persona të tjerë, në rastet e pamundësisë që mund të kenë për të vijuar punën ose në raste të diktuar nga situatat.

## RREZIKU I PANDEMISË COVID-19 DHE REAGIMI NDAJ TIJ

RREZIKU	REAGIMI
Pandemia COVID-19	Hapi 1: Konstatimi i rrezikut të pandemisë. Zbatimi i akteve të organeve kompetente. Hapi 2: Marrja e masave mbrojtëse dhe parandaluese brenda shoqërisë Hapi 3: Rikthimi i personelit. Vijimi i punës duke ruajtur distancën fizike. Hapi 4: Caktimi i orarit të plotë dhe alternimi i personelit të ALBSIG JETË sh.a Hapi 5: Mbrojtja e personelit dhe klientëve (kontaktit me klientët). Hapi 6: Shërbimet online të shoqërisë dhe faqja zyrtare e shoqërisë. Hapi 7: Komunikimi me Autoritetin Mbikqyrës Financiar. Hapi 8: Ndjekja e ecurisë së pandemisë dhe pasojave të shkaktuara personelit dhe/ose biznesit të shoqërisë. Hapi 9: Ndërtimi i strategjisë së biznesit post-pandemi COVID-19.

Në gjendjen e pandemisë së COVID-19, duhet të ndërmerren hapat si më poshtë:

HAPAT:	INSTRUKSIONET:
<b>1: Konstatimi i rrezikut të pandemisë.</b> Zbatimi i akteve ligjore dhe udhëzimeve të organeve kompetente të ngarkuara për përballimin e situatës.	Shpallja e gjendjes së pandemisë nga COVID-19. Zbatohen aktet ligjore, nënligjore dhe aktet e brendshme të shoqërisë për parandalimin e pasojave të pandemisë. Ndiqen udhëzimet specifike të institucioneve të ngarkuara me ligj për përballimin e situatës së shkaktuar nga COVID-19. Burimet e informacionit janë burimet qeveritare (MSHMS, Taskforca e posaçme, organet e zbatimit të ligjit) <a href="https://shendetesia.gov.al/">https://shendetesia.gov.al/</a> .
<b>2: Marrja e masave mbrojtëse dhe parandaluese brenda shoqërisë.</b>	Verifikimi i gjendjes shëndetsore të personelit duke kryer depistim çdo 2 javë për të mbajtur nën kontroll rrezikun e përhapjes së COVID-19. Gjithashtu analizat janë kryer edhe

	<p>për familjarët e afërm të stafit të ALBSIG JETË sh.a;</p> <p>Shpenzimet për të tilla kontrole si dhe ato spitalore do të mbulohet nga shoqëria ALBSIG JETË sh.a;</p> <p>Dezinfektimi i ambienteve të shoqërisë - një herë në javë, nëpërmjet kontraktimit të shoqërive të cilat ofrojnë shërbime dezinfektimi;</p> <p>Sigurimi i maskave dhe dorezave, si dhe vënia në dispozicion të stafit të mjeteve dezinfektuese.</p>
<p><b>3. Rikthimi i personelit në punë dhe vijimësia e punës.</b></p>	<p>Përcaktohet personeli që duhet të sigurojë vijimësinë e punës dhe përcaktohen detyrat specifike. <i>(Plani i veprimit për rikthimin e stafit dhe vijueshmeria normale e orareve të punës në shoqërisë Albsig gjatë periudhës së pandemisë të shkaktuar nga COVID-19)</i></p> <p>Verifikohet që personeli nuk ka simptoma të COVID-19 apo sëmundje të tjera.</p> <p>Në rast të evidentimit të personelit me simptoma të COVID-19, udhëzohet qëndrimi i tyre në shtëpi për një periudhë minimale 2-javore deri në përsëritje të testit serologjik.</p> <p>Përcaktohet personeli që mund të vijojë punën duke ruajtur distancën fizike, brenda dhe jashtë zyre, në përputhje me rregullat në gjendje pandemie.</p>
<p><b>4: Heqja e orarit të reduktuar</b></p>	<p>Përcaktohet orari i plotë i punës për e Shoqërisë ALBSIG JETË sh.a. <i>(Plani i veprimit për rikthimin e stafit dhe vijueshmeria normale e orareve të punës në shoqërisë ALBSIG JETË gjatë periudhës së pandemisë të shkaktuar nga COVID-19)</i></p>
<p><b>5: Marrja e masave për mbrojtjen e personelit dhe klientëve (kontaktit me klientët)</b></p>	<p>Zbatohet plani i masave për shërbimin ndaj klientit, <i>(Plani i veprimit për vazhdimësinë e shërbimit ndaj klientëve)</i> duke respektuar rigorozisht kërkesat ligjore, rregullatore dhe aktet e brendshme të shoqërisë.</p> <p>Në Shoqërinë ALBSIG JETË sh.a janë marrë masat për vendosjen e mjeteve mbrojtëse në hyrje të çdo zyre për klientët dhe për vetë stafin e kompanisë.</p> <p>Kryerja e testit serologjik për stafin e çdo zyre si dhe aty ku shihet e nevojshme dhe e familjarëve përkatës në raste dyshimi.</p>
<p><b>6: Shërbimet online të shoqërisë dhe faqja zyrtare e shoqërisë.</b></p>	<p>Departamenti i IT-së dhe departamentet e tjera mundësojnë funksionimin e shërbimeve online për shitje, njoftimin e</p>

	dëmeve, shërbimet e tjera dhe informacionet e tjera. Merren masa për mirëmbajtjen e këtij shërbimi dhe zgjerimin e mundshëm të tij.
<b>7: Komunikimi me Autoritetin Mbikqyrës Financiar.</b>	Zbatohet Plani i veprimit i hartuar për realizimin e raportimeve periodike (financiare dhe statistikore) në AMF duke respektuar kërkesat e Rregullores nr. 34/2015, e ndryshuar në situatën e krijuar nga pandemia COVID-19.
<b>8: Ndjekja e ecurisë së pandemisë dhe pasojave të shaktuara personelit dhe/ose biznesit të shoqërisë</b>	Analizohen të dhënat periodike të shoqërisë sipas produkteve, degëve, etj dhe ndikimi i pandemisë në biznesin e shoqërisë.  Monitorohet në vijimësi gjendja shëndetësore e personelit, përfshirë dhe atij që punon në distancë. Ndermerren masa për parandalimin e përkeqësimit të gjendjes shëndetësore të çdo punonjësi. Merren masa për të siguruar mbështetje me burime njerëzore për pozicionet kyçe, në çdo situatë.
<b>9: Ndërtimi i strategjisë së biznesit post-pandemisë COVID-19.</b>	Pas analizës së situatës, problematikave dhe vlerësimeve të tjera, ndërtohet një strategji për rikthimin e biznesit në nivelet e para-pandemisë.

#### **KONTAKTET NË RASTE EMERGJENCE:**

##### Shërbimet e Emergjencës:

1. Shërbimi i Urgjencës 127	
2. Ambulanca 112; Policia	
3. Policia	112; 129

##### Komunikimi:

1. Kompania e telefonisë celulare	T Mobile, Vodafone, Eagle mobile 139 (tel cel); Kompania e telefonise fikse Albtelekom 1232; 1233 (për difekte)
-----------------------------------	--

##### Mirëmbajtje dhe Riparim:

1. Shërbime pastrimi	Durime Thanishta
2. Elektrike	0699951700 , 0697819606
3. Shërbime tubacioni	0684099938
4. Sistemi i ajrimit	0682039730

Llogjistika:

1. Dërgesa ekspres	2234914 (TNT Express)
2. Shërbime transporti	0684099938

Shërbimet e Energjisë Elektrike, Ujit, Etj.:

1. Energjia elektrike	2222616
2. Uji	0684099938; 2240972 (Ujesjellesi Tiranë)
3. Ujërat e zeza	2256091

Miratohet

Drejtor i Përgjithshëm

**Z. Ervin SPAHIU**



Zv/Drejtor i Përgjithshëm

**Z. Renato BIHUCI**



Drejtor i Shitjeve

**Z. Denis MUÇODEMA**

